



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1338/ 5 Prot.,

Datë 18.05.2026

**V E N D I M**

**Nr.659 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 18 .05.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026 , nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k, Nipt L82428011G, me adresë: Njësia Administrative nr. 10, Rruga "Fortuzi", Nr. 66/1.
- Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane, me adresë: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24-04-2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane.

II.2. Në datën 29.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6598, protokolluar me nr. 1338/2026 prot, datë 29.04.2026, e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” shpk, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Me shkresën nr. 2239/2 prot, datë 12.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1338/1 prot, datë 14.05.2026, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk, për

procedurën e mësipërme të prokurimit ku ka vendosur mos pranimin e ankesës.(Shkresë e ardhur dhe nëpërmjet sistemit elektronik).

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” sh.p.k për modifikimin e dokumenteve të tenderit, me arsyen se:

...[1. Me date 24.04.2026 është publikuar në SPE procedura E hapur, e thjeshtuar Blerje Mallra me objekt Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre Në këtë procedurë janë bashkuar blerja e mallrave Tonerat për printera dhe pjesë këmbimi dhe Sherbimi I Riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve Fotokopje e printera që AK ka në përdorim. Në këtë procedurë janë bashkuar blerje mallrash (tonera dhe pjesë këmbimi për printera e fotokopje) dhe shërbime që nuk kanë lidhje me njëra tjetrën. Të gjitha mallrat objekt prokurimi, tonerat dhe pjesët e këmbimit janë pjesë që nderrohen nga përdoruesi fundor, pa patur nevojë për punonjës të specializuar. Tonerat, Drum Cartridge, Fuser Unit janë të gjitha pjesë konsumi që nderrohen lehtësisht nga çdo përdorues, dhe nuk përbejnë riparim apo mirëmbajtje, por janë pjesë konsumi që nderrohen me konsumin e tyre pas një numri të caktuar kopjesh, psh toner çdo 30.000 kopje, drum çdo 80.000 kopje, Fuser çdo 100.000 kopje. Ka shumë operatore që tregetojnë tonera për printera dhe pjesë konsumi, por jo të gjithë këta operatore operojnë në fushën e riparimit/mirëmbajtjes të printerave/fotokopjeve Bashkimi I këtyre 2 objekteve në 1, është në kundërshtim me LPP dhe VKM për RPP. Bashkimi I tyre, ul konkurrencën, dhe favorizon OE të cilët krahas tregëtisë së mallrave objekt prokurimi (tonera dhe pjesë konsumi) ofrojnë dhe shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve. Siç shihet dhe nga kriteret e kualifikimit, pavarësisht se zëri Mirëmbajtje përben me pak se 15% të totalit të volumit të kontratës, kriteret që I referohen mirëmbajtjes dominojnë mbi kriteret që I takojnë Blerjes së mallrave (tonera dhe pjesë konsumi) si psh: 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij teknik, minimalisht 4 (katër) punonjës të kualifikuar dhe të çertifikuar si më poshtë: ? Minimalisht 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesit përkatës ose nga institucione të autorizuar çertifikuese, për mirëmbajtjen dhe shërbimin e pajisjeve fotokopje multifunksionale; ? Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar në administrimin e rrjeteve kompjuterike; ? Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar për platformat Microsoft 365 dhe/ose Microsoft Server, ose ekuivalente 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi/ët e pajisjeve që janë objekt i shërbimit, ose nga përfaqësues të autorizuar të tyre, për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit. 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO 27001 Asnjë nga kërkesat e mësipërme nuk lidhet me objektin blerje mallrash, por me mirëmbajtjen. Për sa më sipër, kërkojmë ndarjen e procedurës në 2 lote, një lot Blerje Mallrash Tonerat për printera e fotokopje dhe pjesë konsumi për to dhe një lot Shërbim Mirëmbajtje Fotokopje Vetëm ndarja e tyre garanton ligjshmerinë e procedurës, dhe zhvillimin e saj në përputhje me LPP dhe VKM për RPP, duke garantuar konkurrencën, dhe proporcionalitetin e kriterëve të kualifikimit me objektin e prokurimit ...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, ka parashikuar elementët e procedurës së prokurimit konkretisht: Termat e references dhe specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre” si në vijim:

✚ **Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre.”**

**1. QËLLIMI DHE OBJEKTI**

- Shërbime mirëmbajtje parandaluese dhe riparuese për pajisje multifunksionale (MFP) të markës Xerox;
- Mirëmbajtje dhe mbështetje teknike për sistemin ekzistues të menaxhimit të printimit;
- Furnizim të vzhdueshëm me konsumable origjinale (bojëra/toner, *drum* (cilindër), *waste cartridge* (kasetë për mbledhjen e mbetjeve), fuser (furrë)

**2. FUSHA E SHËRBIMIT**

- Mirëmbajtje parandaluese periodike për të gjitha pajisjet MFP të listuara në Aneksin 1.
- Mirëmbajtje sipas kërkesës, përfshirë diagnostifikimin në terren dhe riparimin e defekteve.
- Mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të printimit (server/aplikacion, klientë, *driver*-a, politika, kuotime, auditim)
- Furnizim i *consumable*-ve origjinale (*toner*/bojë, *drum* (cilindër), *waste cartridge* (kasetë për mbledhjen e mbetjeve), fuser (furrë) sipas modelit dhe sasisë së kërkuar brenda 40(dyzet) ditëve nga lidhja e kontratës.
- Trajnim i shkurtër për përdoruesit kyç dhe personelin IT (kur kërkohet).

**3. KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

Kohëzgjatja e kontratës është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit nga palët, ku furnizimi i *consumable*-ve origjinale do të jete brenda 40 (dyzet) ditëve nga fillimi i saj.

**4. KËRKESAT TEKNIKE MINIMALE**

**4.1. Pajisjet multifunksionale (MFP)- mirëmbajtje**

- Mirëmbajtje parandaluese mujore të dokumentuara: pastrim mekanik, kalibrim *print/scan*, kontroll i *ADF/fuser/rollers*, verifikim sensorësh, testim cilësie dhe ndërrim i tyre kur është i nevojshëm.
- Mirëmbajtje përmirësuese *on-site* me diagnostikim dhe rikthim në funksion sa më shpejt të jetë e mundur.
- Përmirësim, licensim dhe *upgrade firmware* dhe *software* pa pagesë, vetëm kur të rekomandohet nga prodhuesi dhe pas testimit paraprak.
- Zëvendësim i pjesëve të dëmtuara me pjesë origjinale do të kryhet nga furnizuesi, brenda 20 (njëzet) ditësh nga konstatimi dhe njoftimi nga AK. Për rastet emergjente zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara do të kryhet nga furnizuesi brenda 5 (pesë) ditësh nga konstatimi dhe njoftimi nga AK.

- Mbajtje regjistri teknik (*log*) për çdo pajisje: ndërhyrjet, pjesët e zëvendësuara, numëruesit (metër), teste pas riparimit.

#### 4.2. *Sistemi i manaxhimit të printimit-mirëmbajtja*

- Aplikacioni i manaxhimit të softuerit: *Xerox Workplace Suite (XWS)* - kërkesa funksionale dhe operative:
- Autentikim i sigurt në pajisje (PIN/kartë/identifikim i integruar) dhe *secure/pull printing*.
- Integrim me *Microsoft Active Directory/ Azure AD* për përdorues, grupe dhe politikat e printimit.
- Rregulla inteligjente printimi: *duplex* si parazgjedhje, *redirect* në pajisje më efikase, bllokim printimesh me ngjyra sipas politikave.
- Kontabilizim, kuotime me qendër kostoje; raporte të detajuara mbi përdorimin për pajisje/përdorues.
- Printim mobile dhe nga web (portal), përfshirë upload me autentikim.
- Skanim drejt *email/folder/share*; *template* të menaxhuara nga qendra.
- Enkriptim i komunikimit dhe certifikata TLS; *log*-ime për eventet kyçe.
- Disponueshmëri: mekanizma *backup* dhe rikthim; dokumentim i konfigurimit.
- *Driver*-a të testuara për klientët; përshtatshmëri me *OS* të mbështetur nga KESH.

#### 4.3. *Consumable (Pjesë të konsumueshme)*

- Konsumablet (*toner/bojë, drum (cilindër), waste cartridge* (kasetë për mbledhjen e mbetjeve), *fuser* (furrë)) duhet të jenë 100% origjinale të prodhuesit Xerox/ distributori i autorizuar.
- Nuk pranohen produktet të rimbushura, të riprodhuara apo të rindërtuara.
- Nuk pranohen produkte kompatible por vetem Genuine
- Etiketim i qartë i serisë dhe datës së prodhimit.

### 5. NIVELET E SHËRBIMIT (SLA)

- Përpunimi i të dhënave personale në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore.
- Minimizimi i të dhënave dhe fshirje e sigurt e memorieve të pajisjeve pas ndërhyrjeve; asnjë ruajtje e imazheve/*scan*-eve në pajisje.
- Akses në aplikacionin Xerox Workplace Suite vetëm me autorizim dhe llogari të emëruara; auditim i plotë i ndërhyrjeve.
- Trasmetim i të dhënave me protokolle të enkriptuara; menaxhim i certifikatave dhe rishikim periodik i konfigurimeve të sigurisë.
- Ruajtje konfidencialitetit për të gjithë personelin e Operatorit Ekonomik.

## 6. DOREZIMI, PRANIMI DHE GARANCIA

- Pranimi kryhet me procesverbal për shërbimet dhe konsumablat e dorëzuar.
- Garanci për punimet dhe pjesët e zëvendësuara: minimumi 3 muaj.

## 7. ANEKSI I----- TABELA E PAJISJEVE

| Nr. | Përshkrimi            | Vendodhja              | Gjendja e pajisjes |
|-----|-----------------------|------------------------|--------------------|
| 1   | Xerox AltaLink B8100  | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 2   | Xerox AltaLink B8100  | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 3   | Xerox AltaLink B8100  | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 4   | Xerox AltaLink B8100  | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 5   | Xerox AltaLink B8100  | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 6   | Xerox VersaLink C7100 | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 7   | Xerox VersaLink C7100 | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 8   | Xerox VersaLink C7100 | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 9   | Xerox VersaLink C7100 | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 10  | Xerox VersaLink C7100 | Aparati Qëndror KESH   | Në shërbim         |
| 11  | Xerox VersaLink B7100 | KESH sh.a. (Shkozë)    | Në shërbim         |
| 12  | Xerox VersaLink B7100 | KESH sh.a. (Koman)     | Në shërbim         |
| 13  | Xerox VersaLink C7100 | KESH sh.a. (Koman)     | Në shërbim         |
| 14  | Xerox VersaLink B7100 | KESH sh.a. (Fierzë)    | Në shërbim         |
| 15  | Xerox VersaLink B7100 | KESH sh.a. (Fierzë)    | Në shërbim         |
| 16  | Xerox VersaLink C7100 | KESH sh.a. (Fierzë)    | Në shërbim         |
| 17  | Xerox VersaLink B7100 | KESH sh.a. (Vau Dejës) | Në shërbim         |
| 18  | Xerox VersaLink C7100 | KESH sh.a. (Vau Dejës) | Në shërbim         |

Pajisjet që parashikohen në Aparatin Qëndror KESH:

| Përshkrimi                    | Njësia | Sasia |
|-------------------------------|--------|-------|
| Xerox AltaLink B8100          |        |       |
| BLACK TONER ≥ 50,000 faqe     | copë   | 10    |
| WASTE TONER ≥ 120,000 faqe    | copë   | 10    |
| DRUM CARTRIDGE ≥ 200,000 faqe | copë   | 2     |
| Fuser Assembly ≥ 300,000 faqe | copë   | 2     |

| Përshkrimi                          | Njësia | Sasia |
|-------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink C7100               |        |       |
| Black Toner Cartridge ≥ 30.000 faqe | copë   | 20    |

|                                                                |      |    |
|----------------------------------------------------------------|------|----|
| Cyan Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                        | copë | 20 |
| Magenta Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                     | copë | 20 |
| Yellow Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                      | copë | 20 |
| Drum Cartridge (K $\geq 109,000$ faqe, CMY $\geq 87,000$ faqe) | set  | 4  |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe                                | copë | 3  |
| Waste Toner Bottle $\geq 30,000$ faqe                          | copë | 20 |

| Përshkrimi                               | Njësia | Sasia |
|------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink B7100                    |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 33,000$ faqe | copë   | 2     |
| Drum Cartridge $\geq 80,000$ faqe        | copë   | 1     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe          | copë   | 1     |

Pajisjet që parashikohen në HEC Koman:

| Përshkrimi                                                     | Njësia | Sasia |
|----------------------------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink C7100                                          |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 30,000$ faqe                       | copë   | 4     |
| Cyan Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                        | copë   | 4     |
| Magenta Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                     | copë   | 4     |
| Yellow Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                      | copë   | 4     |
| Drum Cartridge (K $\geq 109,000$ faqe, CMY $\geq 87,000$ faqe) | set    | 1     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe                                | copë   | 1     |
| Waste Toner Bottle $\geq 30,000$ faqe                          | copë   | 4     |

| Përshkrimi                               | Njësia | Sasia |
|------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink B7100                    |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 33,000$ faqe | copë   | 4     |
| Drum Cartridge $\geq 80,000$ faqe        | copë   | 1     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe          | copë   | 1     |

Pajisjet që parashikohen në HEC Vau i Dejës:

| Përshkrimi                               | Njësia | Sasia |
|------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink B7100                    |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 33,000$ faqe | copë   | 1     |
| Drum Cartridge $\geq 80,000$ faqe        | copë   | 2     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe          | copë   | 1     |

| Përshkrimi                                                     | Njësia | Sasia |
|----------------------------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink C7100                                          |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 30,000$ faqe                       | copë   | 1     |
| Cyan Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                        | copë   | 1     |
| Magenta Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                     | copë   | 1     |
| Yellow Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                      | copë   | 1     |
| Drum Cartridge (K $\geq 109,000$ faqe, CMY $\geq 87,000$ faqe) | set    | 1     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe                                | copë   | 1     |
| Waste Toner Bottle $\geq 30,000$ faqe                          | copë   | 1     |

Pajisjet që parashikohen në HEC Fierzë:

| Përshkrimi                                                     | Njësia | Sasia |
|----------------------------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink C7100                                          |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 30,000$ faqe                       | copë   | 5     |
| Cyan Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                        | copë   | 5     |
| Magenta Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                     | copë   | 5     |
| Yellow Toner Cartridge $\geq 18,000$ faqe                      | copë   | 5     |
| Drum Cartridge (K $\geq 109,000$ faqe, CMY $\geq 87,000$ faqe) | set    | 1     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe                                | copë   | 1     |
| Waste Toner Bottle $\geq 30,000$ faqe                          | copë   | 2     |

| Përshkrimi                               | Njësia | Sasia |
|------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink B7100                    |        |       |
| Black Toner Cartridge $\geq 33,000$ faqe | copë   | 10    |
| Drum Cartridge $\geq 80,000$ faqe        | copë   | 2     |
| Fuser SPARE $\geq 100,000$ faqe          | copë   | 2     |

Tabela përmblledhëse me sasi të dhe artikujt si me poshtë:

| Përshkrimi                    | Njësia | Sasia |
|-------------------------------|--------|-------|
| Xerox Altalink B8100          |        |       |
| BLACK TONER ≥ 50,000 faqe     | copë   | 10    |
| WASTE TONER ≥ 120,000 faqe    | copë   | 10    |
| DRUM CARTRIDGE ≥ 200,000 faqe | copë   | 2     |
| Fuser Assembly ≥ 300,000 faqe | copë   | 2     |

| Përshkrimi                                           | Njësia | Sasia |
|------------------------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink C7100                                |        |       |
| Black Toner Cartridge ≥ 30.000 faqe                  | copë   | 30    |
| Cyan Toner Cartridge ≥ 18,000 faqe                   | copë   | 30    |
| Magenta Toner Cartridge ≥ 18,000 faqe                | copë   | 30    |
| Yellow Toner Cartridge ≥ 18,000 faqe                 | copë   | 30    |
| Drum Cartridge (K ≥ 109,000 faqe, CMY ≥ 87,000 faqe) | set    | 7     |
| Fuser SPARE ≥ 100,000 faqe                           | copë   | 6     |
| Waste Toner Bottle ≥ 30,000 faqe                     | copë   | 27    |

| Përshkrimi                          | Njësia | Sasia |
|-------------------------------------|--------|-------|
| Xerox VersaLink B7100               |        |       |
| Black Toner Cartridge ≥ 33,000 faqe | copë   | 17    |
| Drum Cartridge ≥ 80,000 faqe        | copë   | 6     |
| Fuser SPARE ≥ 100,000 faqe          | copë   | 5     |

| Përshkrimi  | Njësia | Sasia |
|-------------|--------|-------|
| Mirëmbajtje | muaj   | 12    |

III.1.2 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.4. Neni 21 i Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Neni 15 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik. Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën: termat e referencës; grafikun e ekzekutimit; kërkesat për personelin kryesor; kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

III.1.6. Neni 2 “Qëllimi i ligjit “162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.7. Neni 39 i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale. 2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet. Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. 1. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen. Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve. 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një

*përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorial .*

III.1.8. Neni 84 i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” , “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” , parashikon se:

- 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*
- 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*
- 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*
- 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*
- 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.*
- 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*
- 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.*

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është blerja nga ana e autoritetit kontraktor e mallrave të tilla si: “*Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre*” , Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të paktë .Duke ju kthyer natyrës së objektit të prokurimit, Komisioni vlerëson, furnizimi me tonerë, pjesë këmbimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes nuk qëndrojnë si procese autonome apo të shkëputura nga njëra-tjetra, por formojnë një cikël të integruar teknik, ku funksionaliteti, performanca dhe garantimi i vijueshmërisë së pajisjeve të printimit varen nga ndërveprimi i drejtpërdrejtë ndërmjet këtyre komponentëve. Pikërisht kjo ndërlidhje organike ndërmjet elementëve të sipërcituar e bën objektin e prokurimit substancialisht të pandashëm dhe jo të segmentueshëm në lote të pavarura. Në rastin konkret, ndarja në lote do të krijonte një shkëputje ndërmjet elementëve që teknikisht funksionojnë si pjesë të ndërruar nga njëra tjetra duke qënë se janë të së njëjtës natyrë .Konkretisht cilësia dhe kompatibiliteti i tonerëve dhe pjesëve për pajisjet e printimit ndikojnë drejtpërdrejt në

mirëfunksionimin dhe jetëgjatësinë e pajisjeve të printimit, ndërsa mirëmbajtja efektive e këtyre pajisjeve nuk mund të trajtohet në mënyrë të shkëputur nga materialet dhe komponentët që përdoren në to. Në një situatë me operatorë të ndryshëm ekonomikë për secilin lot, krijohet një probabilitet i lartë për mbivendosje apo shmangie të përgjegjësisë në rast defektesh teknike, duke cenuar qartësinë e përgjegjësisë kontraktore dhe duke rënduar administrimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu duke vijuar më tej e parë nga një këndvështrim i racionalitetit administrativ dhe përdorimit eficient të fondeve publike, trajtimi i këtij objekti në një procedurë të vetme garanton unifikim të standardeve teknike, përgjegjësi kontraktore dhe koherencë operative në ofrimin e shërbimit. Për më tepër, ndarja në lote redukton kostot administrative, minimizon riskun e moskoordinimit ndërmjet kontraktorëve dhe siguron një mekanizëm më efektiv monitorimi dhe llogaridhënieje gjatë ekzekutimit të kontratës.

Në këtë kuptim, mosndarja në lote nuk përbën kufizim të konkurrencës, por ndikon në pëmbushjen e kontratës dhe zbatimin e saj në formë efektive dhe funksionale për Autoritetin Kontraktor, e orientuar kështu pra drejt garantimit të efektivitetit të kontratës publike dhe mbrojtjes së interesit publik në administrimin e burimeve financiare. Për më tepër, shmangia e ndarjes në lote redukton kostot administrative, minimizon riskun e moskoordinimit ndërmjet kontraktorëve dhe siguron një mekanizëm më efektiv monitorimi dhe llogaridhënieje gjatë ekzekutimit të kontratës.

Gjithashtu KPP sjellë në vëmendje se operatorët ekonomik pjesmarrës në një procedurë, në mbështetje të nenit 84 të “ Ligjit për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht e drejta e operatorit ekonomik për t’u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera, me qëllim pëmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Ky parashikim ligjor materializon parimin e nxitjes së konkurrencës dhe aksesit sa më të gjerë në procedurat e prokurimit publik, duke i dhënë mundësi operatorëve ekonomikë të provojnë disponueshmërinë e kapaciteteve teknike, profesionale apo financiare jo vetëm përmes burimeve të tyre të drejtpërdrejta, por edhe përmes mbështetjes së subjekteve të treta. Në këtë kuptim, ligji i ka njohur operatorit ekonomik një hapësirë të qartë për të organizuar kapacitetet e tij, duke i lejuar që të mbështetet në burime të jashtme për të pëmbushur kriteret e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2 .Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues me arsyen se,...[ 2 Korigjim I specifikimeve teknike Ne shtojcen 7 Formulari I Specifikimeve teknike percaktohet: ? Sipas specifikimeve teknike bashkëlidhur DT Bashkangjitur DST gjendet vetem dokumenti termat e references.pdf Ne kete dokument nder te tjera percaktohet: 1. Qellimi dhe Objekti c) furnizim te vazhdueshem me konsumabla origjinale ( toner, drum, ëaste cartridge, fuser unit) 2. Fusha e shërbimit d) furnizim I konsumablave origjinale sipas modelit dhe sasise se kerkuar Brenda 40 diteve. 4.3 Consumablet duhet te jene 100% origjinale te prodhuesit Xerox/Distributor I autorizuar 7. Tabela e Paisjeve: ne te gjitha rreshtat eshte percaktuar prodhuesi I paisjes Xerox Te gjitha keto percaktime jane ne kundershtim me nenin 46 te LPP, pasi percaktojne marken e produktit Xerox, pa vendosur ose ekuivalent , per ti dhene mundesine qe ligji ua garanton OE, qe te ofertojne me produkte qe nuk jane te prodhuara nga Xerox, por qe jane ekuivalente me to. Ka shume prodhues qe prodhojne tonera per printera dhe pjese konsumi , dhe kufizimi qe AK ka vendosur, qe tonerat dhe pjeset e konsumit duhet te jene patjeter Xerox eshte ne kundershtim me ligjin. Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e specifikimeve teknike per tonerat dhe pjeset e konsumit, duke garantuar qe OE te ofertojne edhe me tonera dhe pjese konsumi qe nuk jane prodhuar nga Xerox.], Komisioni vë re se,

III 2.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar “Termat e referencës dhe specifikimet teknike per proceduren e prokurimit me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre ”sipërcituar në pikën III.1.1 të këtij vendimi si dhe në vijim kërkesën në pikën 2 fusha e shërbimit:

#### 1. QËLLIMI DHE OBJEKTI

- Shërbime mirëmbajtje parandaluese dhe riparuese për pajisje multifunksionale (MFP) të markës Xerox;
- Mirëmbajtje dhe mbështetje teknike për sistemin ekzistues të menaxhimit të printimit;
- Furnizim të vzhdueshëm me konsumable origjinale (bojër/toner, *drum* (cilindër), *waste cartridge* (kasetë për mbledhjen e mbetjeve), fuser (furrë)

#### 2. FUSHA E SHËRBIMIT

- Mirëmbajtje parandaluese periodike për të gjitha pajisjet MFP të listuara në Aneksin 1.
- Mirëmbajtje sipas kërkesës, përfshirë diagnostifikimin në terren dhe riparimin e defekteve.
- Mirëmbajtje për sistemin e manaxhimit të printimit (server/aplikacion, klientë, *driver*-a, politika, kuotime, auditim)
- Furnizim i *consumable*-ve origjinale (*toner*/bojë, *drum* (cilindër), *waste cartridge* (kasetë për mbledhjen e mbetjeve), fuser (furrë) sipas modelit dhe sasisë së kërkuar brenda 40(dyzet) ditëve nga lidhja e kontratës.
- Trajnim i shkurtër për përdoruesit kyç dhe personelin IT (kur kërkohet).

#### 3. KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kohëzgjatja e kontratës është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit nga palët, ku furnizimi i *consumable*-ve origjinale do të jete brenda 40 (dyzet) ditëve nga fillimi i saj.

#### 4. KËRKESAT TEKNIKE MINIMALE

##### 4.1. Pajisjet multifunksionale (MFP)- mirëmbajtje

- Mirëmbajtje parandaluese mujore të dokumentuara: pastrim mekanik, kalibrim *print/scan*, kontroll i *ADF/fuser/rollers*, verifikim sensorësh, testim cilësie dhe ndërrim i tyre kur është i nevojshëm.
- Mirëmbajtje përmirësuese *on-site* me diagnostikim dhe rikthim në funksion sa më shpejt të jetë e mundur.
- Përmirësim, licensim dhe *upgrade firmware* dhe *software* pa pagesë, vetëm kur të rekomandohet nga prodhuesi dhe pas testimit paraprak.
- Zëvendësim i pjesëve të dëmtuara me pjesë origjinale do të kryhet nga furnizuesi, brenda 20 (njëzet) ditësh nga konstatimi dhe njoftimi nga AK. Per rastet emergjente zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara do të kryhet nga furnizuesi brenda 5 (pesë) ditësh nga konstatimi dhe njoftimi nga AK.

III.2.1. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e 9 prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1.Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur

prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “ 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.2.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij

neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.2.5. Në nenin 39, pika 2 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: 11 Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit, si dhe në harmoni me parashikimet ligjore si përsa i përket kriterëve kualifikuesë ashtu dhe specifikimeve teknike. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një

proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP-ja gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet, si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Nga interpretimi teologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit

dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.” Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Autoriteti kontraktor është i detyruar të zbatojë me përpikëri dispozitat e LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Referuar përcaktimeve të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra që duhet të prokurohen, AK duhet të ketë parasysh që në hartimin e specifikimeve teknike të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga

konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik, apo të përdoret emër marke produkti, i cili më pas i adreson operatorët drejtë një prodhuesi të vetëm. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi i kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor, konstaton se ky i fundit ka pohuar se çdo operator ekonomik ka të drejtë të ofertojë me mallra të prodhuesve të ndryshëm, por ndërkohë në specifikimet teknike nuk është reflektuar një gjë e tillë përsa kohë që ka të përcaktuar emra markash apo prodhuesish, përdorimi i të cilave shërben si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, pasi i drejton operatorët ekonomik drejtë një prodhuesi të vetëm. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara dhe të mos orientojnë drejt një lloji marke por të jenë gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të hapin konkurrencën.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor në referim të Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, duhet të vendosi termin “*ekuivalente*” në specifikimet teknike në kuptim të asaj cfarë parashikon dhe neni 4 “Përkufizime” pika 7 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, *mbi ekuivalencën ku përcaktohet se: “7. “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.*

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint technologies” shpk më arsyen si në vijim:

*...[“3 Heqja e kriterit kualifikues Autorizim Prodhuesi per tonerat dhe pjeset e konsumit Nder te tjera, ne kriterin 2.3.4 kerkohet: 2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi Ky kriter kufizon konkurencen si dhe pjesemarrjen e Biznesit te Vogel dhe te Mesem, pasi keta te fundit nuk kane mardhenie direkte me prodhuesin, sidomos per nje procedure te hapur te thjeshtuar, ku ligji parashikon vendosjen e kriterëve te kualifikimit te thjeshtezuara, me qellim promovimin e pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem, sidomos kur behet fjale per produkte qe gjendjen lehtesisht ne treg, sic jane tonerat dhe pjeset e konsumit. Per sa me siper kerkojme heqjen e ketij kriteri ...].*

III.3.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 8, të dokumentave standarte të tenderit, pika 2.3.4, ka parashikuar si në vijim kriterin:

**2.3.4** *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*

III.3.2 Autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin elektronik ka publikuar “Procesverbal – tipi i kontratës - mall për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për

kualifikim objekti i procedurës: “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv), toner për makinat fotokopjuese - 30125120-8, vlera e fondit limit: 6,680,016 (Gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.” 29 Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.

III.3.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të 30 kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit

dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.5. Në nenin 40, pika 3 dhe pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në 31 fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.3.6. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit pika 2.3.4 ,Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon,e-mail, ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.3.7 Për sa më sipër referuar pretendimit të operatori ekonomik ankimues, ku kërkon heqjen e kriterit si dhe duke marrë shkas nga kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor, ku operatorët ekonomik duhet të disponojnë autorizim prodhuesi si dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë procesverbalin e argumentimit të publikuar *“Procesverbal – tipi i kontratës - mall për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim objekti i procedurës: “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”*, të publikuar në sistem rezulton se mungon argumentimi teknik konkret se pse kërkohej autorizim prodhuesi, argumentimi i bërë nga autoriteti është jo argumentuar teknikisht por në një argumentim vetëm në prima facie të kërkesës. Qëllimi i autoritetit kontraktor në rastin konkret është realizimi në kohë dhe me cilësi i kontratës objekt - prokurimi. KPP e gjen kërkesën e autoritetit kontraktor jo të arsyeshme, dhe jo në përputhje me natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nëpërmjet kapaciteteve të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh me qëllim përfitimin e shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në çdo rast kriteret kualifikuese duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet. KPP gjykon, në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë në procedurat e prokurimit publik, ka detyrimin që kërkesën për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ta shoqërojë me një argumentim teknik të detajuar, konkret dhe të individualizuar për objektin e prokurimit, duke provuar në mënyrë të qartë dhe bindëse pse ky dokument është i domosdoshëm për realizimin e kontratës. Ky argumentim duhet të evidentojë lidhjen funksionale midis autorizimit të prodhuesit dhe nevojës konkrete të Autoritetit Kontraktor, duke sqaruar ndër të tjera: natyrën teknike të mallrave apo shërbimeve, ekzistencën e ndonjë risku operacional, kërkesat për garanci specifike, nevojën për suport teknik të certifikuar nga prodhuesi, apo elementë të tjerë që e bëjnë të domosdoshme pajisjen e operatorit ekonomik me autorizim të drejtpërdrejtë nga prodhuesi. Vetëm ekzistenca formale e një kërkesë të tillë nuk mjafton për ta bërë atë të ligjshme dhe proporcionale. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk arrin të paraqesë një argumentim teknik të plotë dhe bindës mbi domosdoshmërinë reale të këtij kriteri, atëherë, në zbatim të parimeve të proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe garantimit të konkurrencës efektive, kriteri duhet të hiqet.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik”, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

